



Vlerësim Institucional i Institucioneve të Arsimit të Lartë në Shqipëri

**Raport i Vlerësimit Institucional i
Universitetit Politeknik të Tiranës**

Dhjetor 2016

Përmbajtja

Rreth këtij vlerësimi.....	Error! Bookmark not defined.
Konteksti i këtij vlerësimi	3
Raporti i përmbledhur.....	4
Përmbledhje e gjetjeve.....	6
Gjykimi i përmbledhur	8
Raporti i detajuar.....	Error! Bookmark not defined.
Fusha e Vlerësimit 1: Organizimi dhe Menaxhimi i tij	10
Fusha e Vlerësimit 2: Burimet	Error! Bookmark not defined.
Fusha e Vlerësimit 3: Kurrikula	Error! Bookmark not defined.
Fusha e Vlerësimit 4: Mësimdhënia, Mësimnxënia, Vlerësimi dhe Kërkimi..	Error! Bookmark not defined.
Fusha e Vlerësimit 5: Studentët dhe Mbështetja e tyre	Error! Bookmark not defined.

Rreth këtij vlerësimi

Qëllimi i përgjithshëm i vlerësimit të jashtëm është të vlerësojë në çfarë shkalle IAL-ja përmbush Standardet Shtetërore Shqiptare, që kanë hyrë në fuqi në 2011. Vlerësimi i jashtëm institucional është një proces i vlerësimit me ekspertë të jashtëm, ku çdo grup ekspertësh përbëhet nga ekspertë të Mbretërisë së Bashkuar, të përzgjedhur dhe caktuar nga QAA-UK dhe nga ekspertë shqiptarë të përzgjedhur dhe caktuar nga APAAL. Grupi i Vlerësimit të Jashtëm u drejtua nga një ekspert i QAA-së.

Raportet përfundimtare do të shërbejnë jo vetëm për akreditimin institucional, bazuar në shkallën e përmbushjes së standardeve nga IAL-ja, por dhe për të informuar IAL-të, qeverinë shqiptare, publikun dhe studentët sesi IAL-ja i përmbush standardet. Kjo gjithashtu synon të nxisë IAL-të të punojnë në drejtim të përmirësimit të cilësisë, proces përmes të cilit Institucionet e Arsimit të Lartë sistematikisht përmirësojnë cilësinë e shërbimit dhe mënyrat se si mbështesin studentët për të nxënit.

Standardet Shqiptare Shtetërore të Cilësisë janë grupuar nën pesë Fusha Vlerësimi: Organizimi dhe Menaxhimi i tij; Burimet; Kurrikula; Mësimdhënia, Mësimnxënia, Vlerësimi dhe Kërkimi; dhe Studentët dhe Mbështetja e tyre. Ky raport identifikon karakteristikat e praktikës së mirë, rekomandimet, pohimet e veprimtarisë në zhvillim e sipër dhe dobësitë për çdo Fushë Vlerësimi, së bashku me një gjykim se sa mirë IAL-ja i përmbush standardet. Gjykimet që mund të përcaktojnë ekspertët janë: standardet janë përmbushur plotësisht; standardet janë përmbushur kryesisht; standardet janë përmbushur pjesërisht; ose standardet nuk janë përmbushur.

Së fundi, ekspertët do të japin rekomandime, si një gjykim të përmbledhur për Këshillin e Akreditimit të APAAL-it. Ky gjykim i përmbledhur është një nga katër nivelet e mëposhtme:

- **Standardet Shtetërore të Cilësisë janë përmbushur**
- **Standardet Shtetërore të Cilësisë janë përmbushur kryesisht**
- **Standardet Shtetërore të Cilësisë janë përmbushur pjesërisht**
- **Standardet Shtetërore të Cilësisë nuk janë përmbushur.**

Si pjesë e procesit të përpilimit të raportit, QAA-ja ka dhënë mbështetje me ekspertë për Grupin e Vlerësimit të Jashtëm, për të garantuar që Grupi t'i mbështesë gjetjet e bëra me materiale faktike dhe prova, si dhe duke redaktuar dhe përmbledhur raportin e plotë më poshtë.

Grupi i Vlerësimit të Jashtëm:

Z. Grant Horsburgh
Profesor Jeremy Bradshaw



Profesor Sherif Bundo

Dr. Alketa Grepcka


Z. Stephen Harris

Kryetar
Anëtar

Anëtar

Anëtare

Anëtar



Profesor Jethro Newton

Anëtar

J Newton

Konteksti i këtij vlerësimi

Universiteti Politeknik i Tiranës (UPT) fillimisht u themelua në 1951 si një institucion shtetëror, që përbëhej nga katër degë inxhinierike; Inxhinieria Mekanike, Inxhinieria Elektrike, Inxhinieria e Ndërtimit, dhe Gjeologjisë dhe Minierave. Në vitin 1957, ky institucion u bë Universiteti Shtetëror i Tiranës dhe katedrat ekzistuese u grupuan dhe formuan Fakultetin e Inxhinierisë. Në vitin 1991, u krijua Universiteti Politeknik i Tiranës nga integrimi i fakulteteve inxhinierike të Universitetit të Tiranës, me një strukturë prej katër fakultetesh; Inxhinieria Mekanike, Inxhinieria Elektrike, Inxhinieria e Ndërtimit, dhe Gjeologjisë dhe Minierave. Strukturimi i mëtejshëm në vitin 1994, i themeloi fakultetet si departamente, që u ndanë më tej në seksione. Dy fakultete të tjera, ai i Teknologjisë së Informacionit, dhe i Inxhinierisë Matematike dhe Inxhinierisë Fizike, u krijuan në vitin 2007 së bashku me dy institute shkencore; Instituti i Energjisë, Ujit dhe Mjedisit dhe Instituti i Gjeoshkencës. Më vonë, dy institutet u integruan, për të formuar një njësi të vetme në vitin 2011, Institutin e Gjeoshkencës, Energjisë, Ujit dhe Mjedisit. Struktura aktuale me shtatë fakultete u plotësua në janar të vitit 2013 me krijimin e Fakultetit të Arkitekturës dhe Planifikimit Urban, si një njësi më vete nga Fakulteti i Inxhinierisë.

Në vitin 2005, UPT-ja rristrukturoi paketën e programeve të studimit për të marrë në konsideratë pritshmëritë e Deklaratës së Bolonjës “Zona Evropiane e Arsimit të Lartë”, duke zbatuar programet e studimit me dy cikle në nivel Bachelor dhe Master. Programet e ciklit të dytë u klasifikuan ose si programe Master Profesional, të orientuar nga puna, ose programe të Masterit të Shkencave, që do të siguronin akses në studimet e nivelit doktoral, që çojnë në kualifikimin e ciklit të tretë.

UPT-ja është anëtar i një numri agjencish dhe rrjetesh akademike evropiane të njohura dhe ka nënshkruar memorandume mirëkuptimi me universitete në Kinë, Francë, Greqi, Itali, Japoni, Rumani, Spanjë dhe SHBA.

Raporti i përmbledhur

Universiteti Politeknik i Tiranës (UPT) u themelua fillimisht në 1951 si një institucion shtetëror. Struktura aktuale, që prej vitit 2013, përbëhet nga shtatë fakultete: i Inxhinierisë Mekanike, i Inxhinierisë Elektrike, i Inxhinierisë së Ndërtimit, i Gjeologjisë dhe Minierave, i Teknologjisë së Informacionit, Inxhinierisë Matematike dhe Inxhinierisë Fizike, dhe i Arkitekturës dhe Planifikimit Urban.

Një ekip i Universitetit, që përbëhej drejtues të lartë, staf akademik dhe mbështetës dhe një përfaqësues i studentëve, përgatiti një raport Vetëvlerësimi. Projekt raportet u qarkulluan te një audiencë më e gjerë brenda Universitetit para se të përmbylleshin dhe miratoheshin nga Senati Akademik.

Vizita u realizua në tre ditë ndërmjet 14 dhe 16 Shtator 2016. Grupi i Vlerësimit të Jashtëm përbëhej nga katër ekspertë të lartë britanikë të arsimit të lartë dhe dy anëtarë shqiptarë me eksperiencë nga stafi i institucioneve shqiptare. Grupi i Vlerësimit të Jashtëm u mbështet nga Menaxheri i Vlerësimit dhe një person i caktuar për mbajtje shënimesh nga APAAL-i. Grupit të Vlerësimit të Jashtëm iu vu në dispozicion raporti i Vetëvlerësimit dhe një paketë me dokumente faktike mbështetëse, tetë javë para vizitës së vlerësimit, që më pas u plotësua me dokumentacionin shtesë, që u kërkua. Një gamë e gjerë informacionesh mbështetëse që u siguruan nga Universiteti, i mundësuan Grupit të Vlerësimit që të njihje me strukturën, politikën, procedurat e administrimit dhe natyrën e aktiviteteve të mësimdhënies, të nxënies dhe të kërkimit, që ndërmerren nga institucioni. Dokumentet përfshinin Statutin e Universitetit, Rregulloret Akademike, Raportet Vjetore, procedurat e pranimit dhe orientimit, listën e marrëveshjeve dhe memorandumëve të jashtëme, shembuj informacionit të programeve dhe informacion faktik të mbledhjeve për diskutime.

Gjatë vizitës, Grupi i Vlerësimit të Jashtëm u takua me drejtuesit e lartë, studentët, pedagogët, stafin administrativ dhe mbështetës, si dhe partnerët e jashtëm dhe punëdhënësit. Diskutimi ishte në funksion të sqarimit të procedurave, përgjegjësi dhe pikëpamjeve. U mbajtën shënime në të gjitha mbledhjet. Si pjesë e një vizite në kampusin kryesor, Grupi i Vlerësimit të Jashtëm pa bibliotekën, auditorët, laboratorët dhe zyrat.

Standardet për Organizimin dhe Menaxhimin e saj janë përmbushur kryesisht. Qeverisja dhe kornizat rregullatore të UPT-së janë hartuar për t'u përputhur me kërkesat ligjore kombëtare për institucionet e arsimit të lartë. Kuadri rregullator ekzistues i menaxhimit dhe administrimit, si dhe ai për vendimmarrje kolegjiale, funksionon në mënyrën e duhur, dhe me të cilat stafi i të gjitha niveleve është njohur. Megjithatë, reforma është e nevojshme nëse UPT-ja do të trajtojë shqetësimet e ngritura nga stafi dhe studentët me anë të anketimeve dhe gjatë vizitës, që lidhet me mungesën e një kulture të ngulitur cilësore midis stafit akademik dhe studentëve. Kuadri rregullator, për të mbështetur diskutimet kolegjiale dhe debatin, është e efektshëm dhe funksionon mirë për stafin në të gjitha nivelet. Studentët në përgjithësi treguan ndërgjegjësim për mundësitë e përfaqësimit, por një program trajnimi për anëtarët studentë të Senatit Akademik, dhe të bordeve dhe këshillave të fakulteteve dhe departamenteve do të forcojë efektivitetin e angazhimit dhe përfaqësimit të studentëve në proceset formale të qeverisjes. Vetëqeverisja në çështjet universitare shtrihet në të gjitha njësitë organizative akademike dhe administrative. Do të ishte i dobishëm përfundimi i efektivitetit të vendimmarrjes së Universitetit, duke zhvilluar një sërë prioritetesh të Universitetit, të mbështetur nga objektiva dhe synime të përshtatshme, që fakultetet duhet t'i përfshijnë në planet e fakultetit dhe të departamenteve të tyre. Është pranuar fakti se mungon një proces i koordinuar, për të ndërmarrë kërkime në tregun e punës dhe përdorimin e këtyre të dhënave në planifikimin e programit. Në mënyrë të ngjashme, njihet nevoja për të ndjekur në mënyrë të centralizuar dhe të organizuar punësimin e të diplomuarve. Nuk ka një Zyrë Karriere plotësisht funksionale për ofrimin e mbështetjes dhe

këshillave gjithëpërfshirëse për studentët e saj. Megjithatë, janë ndërmarrë hapa për të zbatuar një shërbim të tillë dhe është identifikuar mundësia dhe hapësira për një zyrë të tillë. Nuk ka pasur progres në planet për të krijuar një Shoqatë Alumni, që do të veprojë si një ndërfaqe midis Universitetit dhe ish-studentëve (alumni) të saj. Me anë të bashkëpunimit me institucionet shtetërore dhe private ofrohen shërbime të ndryshme në dobi të studentëve. Universiteti pranon se profili i tij ndërkombëtar do të përfitonte nga rritja dhe forcimi i tij, pasi ka nivele modeste të mobilitetit në hyrje dhe në dalje, dhe mobiliteti i studentëve hyrës paraqet një sfidë të veçantë.

Standardet për Burimet janë të përmbushur kryesisht. Të gjitha detyrat që kanë të bëjnë me menaxhimin e burimeve njerëzore dhe zbatimin e një politike të përshtatshme dhe të mirëpërcaktuar të rekrutimit për stafin pedagogjik akademik dhe ndihmës janë të përcaktuara qartë. Ka mekanizma të përshtatshëm në funksion të menaxhimit të aseteve të Universitetit. Ekziston një qasje strategjike për të siguruar që i gjithë stafi të ketë burime të përshtatshme. Gjithë stafi përgatit një raport vjetor mbi programin e tyre të mësimdhënies dhe punën kërkimore, i cili vlerësohet në nivelin e departamentit. Performanca e punës kërkimore mbikëqyret nga Këshillat e Fakultetit dhe nga Qendra e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë, dhe diskutohet dhe miratohet nga Senati. Nuk ekziston një politikë gjithëpërfshirëse e zhvillimit shoqëror për të gjithë studentët dhe stafin, por pranohet se politikat sociale duhet të pasqyrohen në zhvillimin e ri. Universiteti siguron mjetet e nevojshme për të zbatuar politikën e vet financiare, që bazohet në një kornizë ligjore transparente dhe të përshtatshme dhe të përcaktuar mirë. Ekziston një sistem informacioni i koordinuar, dhe informacioni shpërndahet në kopje fizike ose në format elektronik. Sidoqoftë, përmbajtja dhe cilësia e informacionit nuk është e unifikuar në mbarë institucionin, ku disa faqe interneti të fakultetit nuk kanë informacion të rëndësishëm për studentët ose paraqesin informacion të vjetruar. Aktivitetet në fushën e teknologjisë janë koordinuar në mënyrë efektive. Megjithatë, studentët në takimet dhe nëpërmjet anketimeve raportojnë se në shumë raste pajisjet laboratorike dhe hardueri dhe softueri kompjuterik janë të vjetruara dhe nuk janë në gjendje të mbështesin kërkesat e modulit. Sigurohet ruajtja dhe mirëmbajtja përkatëse e trashëgimisë akademike, kulturore dhe shkencore në Bibliotekën Shkencore dhe Bibliotekën Kombëtare. Zhvillimi i objekteve laboratorike, trajtimi i problemeve të shëndetit dhe sigurisë dhe përmirësimi i shërbimeve për studentët me probleme të lëvizshmërisë janë identifikuar si fusha më me përparësi për t'u zhvilluar.

Standardet për Kurrikulën janë përmbushur plotësisht. Programet e ofruara nga Universiteti mbulojnë të tre ciklet e Bolonjës dhe përputhen me strategjinë institucionale, dhe zbatimi praktik i njohurive dhe aftësive është një element thelbësor i ofrimit. Numri i kurseve, që mund të cilësohet si edukim në vazhdim, është i vogël dhe Universiteti duhet t'i japë përparësi zhvillimit të programeve të studimit që janë të konceptuara, për të zgjeruar pjesëmarrjen dhe për të tërhequr studentët që rikthehen. Në tërësi, proceset sigurojnë që programet e studimit ofrohen në përputhje me strategjinë e zhvillimit të institucionit dhe në përputhje me kërkesat vendore, kombëtare dhe ndërkombëtare. Pranohet që Universiteti po ndërmerr veprime për të rritur numrin e studentëve, në krahasim me kapacitetin institucional, duke marrë kontrollin e kuotave të studentëve dhe duke zhvilluar strukturat e tij. Do të jetë e dobishme të zhvillohet dhe të zbatohet një mekanizëm për të garantuar që të gjithë studentët të kenë informacion të besueshëm dhe të përditësuar të programit, duke përfshirë objektivat e të nxënies dhe metodat e vlerësimit. Vlerësimi i manualeve të programeve konfirmon pohimin e Universitetit, se programet e ciklit të parë janë ndërtuar për të zhvilluar aftësitë themelore në lëndët kryesore, duke u mbështetur në njohuritë e fituara në shkollat e mesme. Megjithatë, Universiteti pranon se ka mungesë të strukturave institucionale për të mbështetur udhëzimin dhe orientimin e studentëve të rinj dhe ka prirje më shumë sesa duhet për t'u mbështetur në nismat e stafit akademik. Ka një numër masash përkatëse, për të lehtësuar mobilitetin e studentëve shqiptarë në Evropë dhe më gjerë. Studentët vlerësojnë modulet për sipërmarrjen dhe menaxhimin e biznesit. Zyra e Karrierës ka një iniciativë për të

zhvilluar më tej modulet ekzistuese dhe për të futur aktivitete të ngjashme te fakultetet dhe te një gamë të gjerë lëndësh.

Standardet për Mësimdhënien, Mësimnxënien, Vlerësimin dhe Kërkimin janë përmbushur kryesisht. Ekzistojnë mekanizma të përshtatshëm për të siguruar organizimin dhe dokumentimin efikas të programeve studimore. Sidoqoftë, do të ishte i dobishëm një mekanizëm, për të siguruar që dispozitat rregulluese të partneritetit të zbatohen ashtu siç janë parashikuar dhe që studentët të jenë plotësisht të mbështetur gjatë stazhit ose praktikës profesionale. Ekzistojnë politika dhe mekanizma të përshtatshme dhe të efektshme, për të siguruar që lektorët të vlerësohen rregullisht, dhe ka një strukturë të përshtatshme mbështetëse, për të nxitur përmirësimin e vazhdueshëm të mësimdhënies. Janë nxitur projekte kërkimore në nivel kombëtar, rajonal dhe evropian. Megjithatë, Universiteti nuk ka një strategji të publikuar të kërkimit, për t'i dhënë përparësi veprimtarisë kërkimore, që identifikon prioritetet dhe një politikë të vlerësimit dhe transferimit të rezultateve të kërkimit. Ka pak marrëveshje me institucionet e tjera të interesuara në rezultatet e kërkimit të Universitetit, brenda ose jashtë vendit, dhe transferimi ose njohja e arritjeve në kërkimet shkencore është sipërfaqësore.

Standardet për Studentët dhe Mbështetjen e tyre janë përmbushur kryesisht. Studentët e programeve të ciklit të parë vijnë direkt nga shkollat e mesme shqiptare. Programet e ciklit të dytë dhe të tretë shpallen në faqet e internetit të fakultetit dhe në ambientet e fakultetit. Faqja e internetit e Universitetit ofron informacion të përgjithshëm dhe çdo fakultet ka faqen e vet, për t'iu ofruar studentëve dhe stafit informacionin përkatës. Studentët pohuan se informacioni që ata marrin është i mjaftueshëm për nevojat e tyre. Studentët me aftësi të kufizuara, studentët nga prindër me aftësi të kufizuara, studentët që janë jetimë, studentët me vështirësi financiare, studentët që janë fëmijë të policëve të rënë në krye të detyrës, si dhe romë dhe egjiptianë mbështeten nga disponueshmëria e bursave në shumën e plotë, ose të pjeshme të tarifave të shkollimit të tyre. Një fushë me përparësi për zhvillimin e infrastrukturës është përmirësimi i lehtësive për studentët dhe stafin me aftësi të kufizuara. Ka një mungesë të teksteve akademike bashkëkohore në të gjitha bibliotekat dhe mungesë e ofrimit të kategorisë së librave apo revistave elektronike. Për studentët e ciklit të parë nuk ekziston një sistem formal për caktimin e kujdestarëve individualë në të gjithë Universitetin. Nuk ka një nivel të lartë të angazhimit të studentëve në diskutimet dhe proceset institucionale vendimmarrëse. Mbështetja që marrin studentët nga stafi akademik për të gjetur punë pas diplomimit, varion dhe zakonisht bazohet në fuqinë e kontakteve personale. Partnerët e jashtëm ishin unanimes në të shprehurit e kënaqësisë për marrëdhënien që ata kanë me Universitetin. Stazhi i studentëve është të natyrës ad hoc, pasi nuk ekziston një sistem formal. Krijimi i Shoqatës Alumni do të ishte një hap pozitiv përparues për Universitetin në formalizimin e lidhjeve të tij me biznesin dhe industrinë, për të përmirësuar punësimin e studentëve dhe për të krijuar mundësi për përafrimin e kurrikulave me kërkesat e tregut.

Gjatë arritjes së këtyre gjykimeve, Grupi i Vlerësimit të Jashtëm identifikoi pesë fusha ku Universiteti ka pranuar se nevojitet zhvillim i mëtejshëm dhe ka pohuar veprimin e propozuar të Universitetit. Së fundi, Grupi i Vlerësimit të Jashtëm ka bërë një sërë rekomandimesh që Universiteti të shikojë si një mënyrë, për të siguruar më tej cilësinë dhe standardet e programeve të tij dhe për të rritur përvojën e të mësuarit të studentëve të vet.

UPT ndërmori vlerësimin në përputhje me udhëzimet e APAAL-it. Grupi i Vlerësimit të Jashtëm konfirmon nivelin e angazhimit të Universitetit me procesin, si dhe bashkëpunimin që i është ofruar Grupit të Vlerësimit të Jashtëm gjatë gjithë fazës së vizitës.

Grupi i Vlerësimit të Jashtëm arrin në përfundimin se Standardet e Cilësisë janë përmbushur plotësisht në një fushë dhe janë përmbushur kryesisht në katër fusha.

Përmbledhje e gjetjeve

Praktika e mirë

Grupi i Vlerësimit të Jashtëm nuk identifikoi asnjë karakteristikë të praktikës së mirë.

- Nuk është identifikuar asnjë.

Dobësitë

Grupi i Vlerësimit të Jashtëm identifikoi dobësitë e mëposhtme:

- mungesën e një procesi të koordinuar për të ndërmarrë kërkime në tregun e punës dhe përdorimin e këtyre të dhënave në planifikimin e programeve (pika 1.9)
- mungesën e gjurmimit të centralizuar dhe të organizuar të punësimit të të diplomuarve (pika 1.10)
- mungesën e përparimit në krijimin e një Rrjeti Alumni, për të vepruar si një ndërfaqe midis Universitetit dhe alumni të vet (pika 1.12)
- mungesën e një politike gjithëpërfshirëse të zhvillimit social, për të gjithë studentët dhe stafin (pika 2.4)
- përmbajtja dhe cilësia e informacionit nuk është e unifikuar në të gjithë institucionin, ku disa faqe interneti të fakultetit nuk kanë informacion të rëndësishëm për studentët ose paraqesin informacion të vjetër (pika 2.8)
- në disa raste, pajisjet laboratorike dhe pajisjet kompjuterike harduer dhe softuer janë të vjetruara dhe nuk mund të mbështesin kërkesat e modulit (pika 2.9)
- mungesën e menaxhimit të fuqishëm të marrëveshjeve të partneritetit (pika 4.1)
- mungesën e një politike të koordinuar institucionale për t'i dhënë përparësi veprimtarisë kërkimore dhe për të mbështetur rezultatet e vlerësimit (pika 4.4)
- sigurimin jo siç duhet të teksteve shkollore me cilësi të përshtatshme dhe sasi të mjaftueshme (pika 5.8).

Rekomandime

Grupi i Vlerësimit të Jashtëm dha rekomandimet e mëposhtme:

- të zhvillojë dhe të zbatojë një mekanizëm, që nxit promovimin dhe krijimin e një kulture të cilësisë në të gjitha njësitë dhe të gjitha nivelet dhe zhvillimin e procedurave të përshtatshme akademike të monitorimit dhe vlerësimit të cilësisë (pika 1.2)
- të sigurojë një program trajnimi për anëtarët studentë të Senatit Akademik dhe të bordeve dhe këshillave të fakulteteve dhe departamenteve (pikat 1.4 dhe 5.10)
- të sigurohet që Strategjia e re e Zhvillimit të identifikojë një sërë përparësish të Universitetit, të mbështetura nga objektivat dhe synimet e duhura që fakultetet duhet të trajtojnë në planet e tyre të fakultetit dhe të departamenteve (pika 1.6)
- të zhvillojë një studim vjetor të nevojave të tregut vendor dhe rajonal të punës dhe të përdorë rezultatet, për të rishikuar dhe përmirësuar ofrimin akademik (pika 1.9)

- të krijojë një Shoqatë Alumni për të diplomuarit e vet (pika 1.12)
- të forcojë qasjen e tij strategjike ndaj ndërkombëtarizimit, duke zhvilluar një politikë afatgjatë për rritjen e numrit të studentëve dhe ekspertëve akademikë ndërkombëtarë në të gjitha departamentet dhe fakultetet (pika 1.15)
- të zhvillojë dhe të zbatojë një politikë gjithëpërfshirëse të zhvillimit shoqëror për studentët dhe stafin (pika 2.4)
- të zhvillojë dhe të zbatojë një proces të gjerë të menaxhimit të informacionit të institucioneve i cili siguron që faqet e internetit të fakultetit të ofrojnë informacion të saktë, të plotë dhe të përcaktuar qartë (pikat 2.8, 3.7 dhe 5.2)
- të zhvillojë dhe të zbatojë një proces të gjerë universitar që garanton se kërkesat e modulit të vazhdojnë të mbështeten plotësisht nga burime të përshtatshme të të nxënësve, duke përfshirë laboratorët dhe teknologjinë (pika 2.9)
- në përputhje me Kartën e Universiteteve Evropiane për të Mësuarit gjatë Gjithë Jetës, të japë përparësi zhvillimit të programeve studimore që janë të konceptuara për të zgjeruar pjesëmarrjen dhe për të tërhequr studentët e rritur të rikthyer (pika 3.2)
- të zhvillojë dhe të zbatojë një mekanizëm për të siguruar që të gjithë studentëve u sigurohen informacione të besueshme dhe të përditësuara të programit, duke përfshirë objektivat e të nxënësve dhe metodat e vlerësimit (pikat 3.7, 5.2 dhe 5.5)
- të zhvillojë dhe të zbatojë një qasje më të strukturuar për udhëzimin dhe orientimin e studentëve, duke përfshirë koordinimin dhe mbështetjen e nismave të pjesëtarëve të stafit mësimdhënës (pikat 3.9, 5.2 dhe 5.5)
- të zhvillojë dhe zbatojë një politikë, për të siguruar që dispozitat rregulluese të partneritetit të zbatohen ashtu siç janë parashikuar dhe që studentët të mbështeten plotësisht gjatë stazhit ose praktikave të trajnimit (pika 4.1)
- të zhvillojë dhe zbatojë një qasje strategjike për kërkimin shkencor që identifikon prioritetet dhe një politikë të vlerësimit dhe transferimit të rezultateve të kërkimit shkencor (pika 4.4)
- të miratojë masa për të përmirësuar stokun e librave dhe për t'i dhënë përparësi projektit që tashmë është duke u zhvilluar për të futur aksesin në libra dhe revista elektronike (pika 5.8).

Pohim i veprime të ndërmarra

Grupi i Vlerësimit të Jashtëm pohon se aktualisht po ndërmerren veprimet e mëposhtme:

- Veprimi për themelimin e një Zyre Karriere për Studentët dhe Këshillimi për Punësimin (pika 1.11)
- Përfshirja e studentëve në zhvillimin e faqeve online të fakultetit, nën mbikëqyrjen e stafit akademik përkatës (pika 2.8)
Angazhimi strategjik për të përmirësuar strukturat në ndërtesat e vjetra për studentët me probleme të lëvizshmërisë (pikat 2.12, 2.14 dhe 5.6)
- Përpjekjet për të shtuar numrin e studentëve në lidhje me kapacitetin institucional, duke marrë kontrollin e kuotave të studentëve dhe duke zhvilluar strukturat e tij (pika 3.6)
- Projekti për të trajtuar cilësinë dhe sasinë e teksteve shkollore (pika 5.8).

Përmbledhje e gjykimeve për çdo Fushë të Vlerësimit

1. Standardet për Organizimin dhe Menaxhimin e tij janë përmbushur kryesisht.
2. Standardet për Burimet janë përmbushur kryesisht.
3. Standardet për Kurrikulën janë përmbushur plotësisht.
4. Standardet për Mësimdhënie, Mësimnxënie, Vlerësim dhe Kërkim janë përmbushur kryesisht.

5. Standardet për Studentët dhe Mbështetja e tyre janë përmbushur kryesisht.

Gjykimi i përmbledhur

Grupi i Vlerësimit të Jashtëm i rekomandon Këshillit të Akreditimit se Standardet Shtetërore të Cilësisë tek Universiteti Politeknik i Tiranës janë përmbushur kryesisht.

Raport i Detajuar

Fusha e Vlerësimit 1: Organizimi dhe Menaxhimi i tij

1.1 Qeverisja dhe kornizat rregullatore të UPT-së janë hartuar për t'u harmonizuar me kërkesat ligjore kombëtare për Institucionet e Arsimit të Lartë dhe Universiteti vepron në përputhje me kërkesat e Statutit të vet dhe Rregullat e Brendshme. **[Dokumentet e RVV 1.1-1.5 & 3.8; Dokumenti i Qartësimit fq. 3 (1); Mbledhjet 1,3 & 4]** Statuti mbështet Misionin e Universitetit dhe është përshtatur sipas kërkesave të autoriteteve të jashtme rregullatore. **[RVV fq. 11]** Që nga tetori i vitit 2015, me hyrjen në fuqi të legjisllacionit të ri të arsimit të lartë, UPT-ja ka filluar zbatimin e ndryshimeve në strukturën dhe funksionimin e institucionit. Këto aktivitete do të sigurojnë pajtueshmëri me kërkesat e ligjit të ri dhe aktet nënligjore përkatëse, kur ato të miratohen dhe kuptohen nga stafi. **[Mbledhjet 4,8 & 9]**
[Kapitulli III, Standardi I.1]

1.2 Marrëveshjet ekzistuese për menaxhimin dhe administrimin e UPT-së dhe për vendimmarrjen kolegjiale, funksionojnë në mënyrë të duhur dhe kuptohen mirë nga stafi në të gjitha nivelet. **[Mbledhjet 3, 4,8 & 9; Dokumenti i Qartësimit fq. 7 (17)]** Marrëveshjet organizative tashmë janë bërë ose janë në proces të zbatimit, për të marrë parasysh plotësisht legjisllacionin e ri. Megjithatë, reforma e mëtejshme është e nevojshme nëse UPT-ja do të trajtojë shqetësimet e ngritura nga stafi dhe studentët, në anketimet dhe gjatë vizitës, në lidhje me mungesën e një kulture të ngulitur cilësore midis stafit akademik dhe studentëve. **[pyetësorët e APAAL-it; dokumente RVV 1.6& 4.10; Dokumenti i Qartësimit fq. 13(2); Dokumenti i vizitës 3; Mbledhjet 2,4-6&9]** Rekomandohet që roli i Universitetit të zhvillohet dhe të zbatohet një mekanizëm, i cili nxit promovimin dhe zotërimin e një kulture të cilësisë në të gjitha njësitë dhe të gjitha nivelet dhe zhvillimin e procedurave përkatëse të monitorimit dhe vlerësimit të cilësisë akademike. **[Kapitulli III, Standardi I.2]**

1.3 UPT-ja ka zhvilluar dhe zbatuar masa efektive për të mbështetur diskutimet dhe debatin kolegjial të cilat i shërbejnë stafit në të gjitha nivelet. **[RVV fq. 11; Dokumenti i Qartësimit p 4 (5); dokumenti i vizitës 9; informacion shtesë 1 & 11; Mbledhjet 4,8 & 9]** Bordet dhe këshillat mbledhen rregullisht dhe informacioni mbi pikat e rendit të ditës i vihet në dispozicion stafit paraprakisht. **[Mbledhjet 8-10]** Anëtarët e Rektoratit dhe drejtuesit e lartë në nivel fakulteti dhe departamenti janë përgjegjës për monitorimin e zbatimit të vendimeve. **[Kapitulli III, Standardi I.3]**

1.4 Studentët në përgjithësi shfaqën vetëdijen për mundësitë për përfaqësim. **[Mbledhjet 5 dhe 6]** Megjithatë, është e paqartë nëse studentët marrin informacion mbi pikat e rendit të ditës të këshillit dhe bordeve. **[Mbledhjet 5 dhe 6]** Përdorimi i mjeteve joformale nga ana e studentëve me stafin akademik dhe autoritetet e Universitetit u mundëson atyre të ngrenë çështje dhe të dëgjojnë zërin e studentëve. **[Mbledhjet 5 dhe 6]** Studentët gjithashtu i shohin aktivitetet e Senatit të Studentëve pozitivisht dhe janë të angazhuar në mënyrë aktive për funksionimin e tij. Megjithatë, UPT-ja nuk ofron një program trajnimi për të mbështetur përfaqësimin dhe angazhimin e studentëve. **[Mbledhjet 4-6]** Për të forcuar efektivitetin e angazhimit dhe përfaqësimit të studentëve në proceset e tyre qeverisëse, rekomandohet që UPT-ja të ofrojë një program trajnimi për anëtarët studentë të Senatit Akademik, dhe bordeve dhe këshillave të fakulteteve dhe të departamenteve. **[Kapitulli III, Standardi I.6]**

1.5 Vetëqeverisja në çështjet e Universitetit shtrihet në të gjitha njësitë organizative akademike dhe administrative, në mësimdhënie dhe veprimtari shkencore, në çështje financiare dhe administrative dhe në miratimin e marrëveshjeve të Universitetit me organet e jashtme. **[RVV fq. 7-8; Dokumenti i Qartësimit fq. 5 (9); Mbledhjet 3, 8 & 9]** UPT-ja ka qenë proaktive në kërkimin e mundësive të financimit të jashtëm dhe ka përfutur nga një

sërë programesh dhe projektsh evropiane dhe ndërkombëtare. **[Dokumente RVV 1.23-1.30, 3.12 & 4.16; Mbledhjet 1,3,8 & 9]** Është në proces të efektshëm auditimi dhe kontrolli të brendshëm të ndërmarrë nga njësia e auditimit të brendshëm që ndodhet në Rektorat. **[RVV fq. 8; Dokumenti RVV 2.71; Dokumenti i Qartësimit p 6(11) & fq. 7(15); Mbledhjet 4 & 7] [Kapitulli III, Standardi I.4]**

1.6 Ndërgjegjësimi i stafit dhe qasja në strategjinë e UPT-së është e përshtatshme dhe ka pasur diskutim në faza të ndryshme të zhvillimit, si në organet drejtuese, ashtu edhe në këshillat për qëllimi diskutimi. **[RVV fq. 11; Dokumenti RVV 1.3; Mbledhjet 1-4 & 7-10]** Strategjia 2016-2017 është hartuar në përputhje me Misionin, Vizionin dhe Qëllimin e Universitetit dhe përmban objektiva të përshtatshme dhe veprime shoqëruese për të mbështetur zbatimin. **[RVV fq. 8; Dokumenti RVV 1.3]** Megjithatë, plani strategjik aktual ka një jetëgjatësi prej vetëm dy vitesh, gjë që në krahasim me praktikën më të mira ndërkombëtare është e shkurtër. **[Dokument i Qartësimit fq. 5 (8); Mbledhjet 1 & 3]** Përpos kësaj, procesi i planifikimit fillon në nivelin e fakultetit dhe të departamentit dhe i mungon një mekanizëm, për të siguruar një lidhje të ngushtë midis prioriteteve strategjike të Universitetit dhe prioriteteve të përcaktuara në nivelin e fakultetit dhe departamentit. **[Mbledhjet 3, 4 & 8-10]** Marrëveshjet për monitorim të efektshëm e të rregullt dhe vlerësimi i përparimit të Universitetit ndaj prioriteteve strategjike dhe përparimit të fakulteteve kundrejt këtyre objektivave dhe synimeve ka gjasa të jenë në rrezik. Për të forcuar efektivitetin e vendimmarrjes së Universitetit, **rekomandohet** që Strategjia e re e Zhvillimit të identifikojë një sërë prioritetesh të Universitetit, të mbështetura nga objektivat dhe synimet e duhura që fakultetet duhet të përfshijnë në planet e fakultetit dhe të departamenteve të tyre. **[Kapitulli III, Standardi I.5]**

1.7 Raporti vjetor i paraqitur në Ministrinë e Arsimit dhe Sportit (Ministria) ofron një pasqyrim të plotë të veprimtarive arsimore dhe shkencore të brendshme dhe të jashtme dhe bazohet në një proces të zgjatur vetëvlerësimi i cili kuptohet nga stafi. **[RVV fq. 8; Dokumente RVV 1.21, 1.22, 3.1-3.6 & VI.: Vlerësimi i Mësimdhënies dhe Kërkimit); Mbledhjet 5-9]** Raporti bazohet në informacionet e raporteve të Vetëvlerësimit mbi aktivitetet e mësimdhënies të përfunduara në fund të vitit akademik nga departamentet dhe programet e studimit, si dhe në raportet e departamenteve për aktivitetet kërkimore të cilat përmbillen në fund të vitit kalendarik. **[RVV fq. 11; Dokumente RVV 3.1-3.6; Shih dokumentet 6 dhe 7; Mbledhjet 7-9]** Raportet e Departamentit diskutohen në këshillat e fakultetit dhe raportet e përbëra të fakulteteve iu përcillen Zëvendës Rektorëve nga dekanët, të cilët bashkërisht e përfundojnë raportin vjetor që i përcillet Senati Akademik për miratim, para dorëzimit në Ministri. **[RVV fq. 11; Dokumente RVV 1.21 & 1.22]** Raporti i miratuar është vënë në dispozicion në faqen e internetit të Universitetit. **[Kapitulli III, Standardi I.6]**

1.8 UPT ka struktura të efektshme të menaxhimit, ekzekutivit dhe administratës të cilat janë të ndara nga strukturat akademike dhe njësitë organizative. Strukturat dhe rregullimet kuptohen nga stafi dhe pasqyrojnë ligjin në fuqi të arsimit të lartë. **[RVV fq. 8-9]** Departamentet janë njësia kryesore për mësimdhënie dhe kërkim shkencor dhe secili ka së paku shtatë anëtarë të plotë të stafit akademik, prej të cilëve minimumi tre prej tyre duhet të kenë kualifikim doktorat ose titullin akademik Profesor. Të gjitha veprimtaritë e mësimdhënies dhe kërkimit shkencor bazohen në parimet e lirisë akademike dhe kontribuojnë në misionin, qëllimin dhe objektivat e Universitetit. **[Dokumente RVV 1.21 & 1.22; Mbledhjet 2,4, 8 & 9]** Stafi akademik ushtron pavarësi në mësimdhënie, kurrikula dhe veprimtari kërkimore, si dhe në organizimin e programeve studimore. **[RVV fq. 9; Dokumente RVV 1-3.38.5; Mbledhjet 8 dhe 9]** Këshillat akademikë dhe organet drejtuese mundësojnë përfshirjen e plotë të stafit në diskutim, debat dhe vendimmarrje. **[RVV p 11; Dokumenti i vizitës 9; Mbledhjet 3 & 8-10] [Kapitulli III, Standardi II.1]**

1.9 Në lidhje me punësimin, pranimet dhe përdorimin e informacionit publik, UPT-ja

respekton dhe vepron në përputhje me rregullat mbizotëruese të konkurrencës. **[RVV fq. 9; Dokumenti RVV 1.3; Mbledhjet 4 dhe 7]** Megjithatë, UPT-ja e pranon mungesën e një procesi të koordinuar për të ndërmarrë kërkime në tregun e punës dhe përdorimin e këtyre të dhënave në planifikimin e programit. **[RVV fq. 8]** Për të trajtuar këtë **dobësi** dhe për të ndihmuar me zhvillimin e planit të ri strategjik, **rekomandohet** që Universiteti të zhvillojë një anketim vjetor të nevojave të tregut vendor dhe rajonal të punës dhe të përdorë rezultatet për të rishikuar dhe përmirësuar ofertën akademike. Në zbatimin e këtij rekomandimi, duhet t'i kushtohet vëmendje praktikës ekzistuese në fakultete, ku aktivitetet e kërkimit të tregut janë ndërmarrë aktualisht për t'u mundësuar atyre marrjen e informacionit dhe të dhënave për nevojat e punësimit rajonal dhe vendor. **[Dokumentit RVV 1.3; Dokumenti i vizitës 4; Mbledhjet 8, 9 & 11] [Kapitulli III Standardi III.1]**

1.10 Në mënyrë të ngjashme, UPT-ja njih nevojën për një gjurmim të centralizuar dhe në mënyrë organizuar të punësimit të të diplomuarve. **[Dokumentit i Qartësimit fq. 13(1); Mbledhja 4]** Disa fakultete ndërmarrin veprimtari kërkimore të tregut, për t'u mundësuar atyre marrjen e informacionit dhe të dhënave për rezultatet e punësimit të të diplomuarve, por nuk ekziston një mekanizëm që siguron mbikëqyrjen e Universitetit. Për ta trajtuar këtë **dobësi**, **rekomandohet** që të ngrihet një mekanizëm i organizuar në nivel qendror, për të mundësuar që punësimi i të diplomuarve dhe rezultatet të gjurmohen në nivel qendror. Në zbatimin e këtij rekomandimi duhet t'i kushtohet vëmendje praktikës ekzistuese në fakultetet, ku rezultatet e punësimit të të diplomuarve janë aktualisht të identifikuar. **[Kapitulli III Standardi III.1]**

1.11 UPT-ja nuk ka një Zyrë Karriere plotësisht funksionale për ofrimin e këshillave dhe mbështetjes gjithëpërfshirëse për studentët e saj. **[Dokumentit i Qartësimit fq. 7(16); Mbledhja 3]** Megjithatë, po ndërmerren hapa për zbatimin e një shërbimi të tillë dhe është identifikuar një hapësirë për ngritjen e kësaj zyre. **[Mbledhja 10]** Rrjedhimisht, evidentohet pohimi i veprimit për krijimin e një Zyre Karriere për Studentët dhe Këshillimi për Punësim. **[Kapitulli III, Standardi III.1]**

1.12 Ka pasur mungesë ecurie në UPT për krijimin e një Rrjeti Alumni, që do të vepronte si një ndërfaqe midis Universitetit dhe ish-studenteve të saj. **[RVV fq. 9; Dokumenti RVV 4.9; Dokumentit i Qartësimit fq. 13 (1); Mbledhja 11]** Për ta trajtuar këtë **dobësi** **rekomandohet** që UPT-ja të vendosë si çështje prioriteti krijimin e një Rrjeti Alumni për të diplomuarit e saj. **[Kapitulli III Standardi III.1]** Në zbatimin e këtij rekomandimi duhet të merret parasysh caktimi i këtij roli për Zyrën e Karrierës së Studentëve dhe Këshillimit për Punësimin. **[Kapitulli III, Standardi III.1]**

1.13 UPT-ja bazon politikat dhe veprimtarinë e saj institucionale në ndjekjen e bashkëpunimit dhe partneritetit në nivel rajonal, kombëtar dhe ndërkombëtar në përputhje me Planin e saj Strategjik 2016-2017. **[RVV fq. 10]** Universiteti bashkëpunon me një sërë organizatash qeveritare dhe joqeveritare, shpesh nëpërmjet marrëveshjeve të nënshkruara. Stafi përfiton nga marrëveshjet e bashkëpunimit me Institucionet e tjera të Arsimit të Lartë në nivel kombëtar dhe ndërkombëtar, nëpërmjet lidhjeve të kërkimit shkencor dhe mundësive për mobilitet ndërkombëtar. Kjo shton vlerën e programeve studimore të UPT-së dhe ndihmon në përmbushjen e nevojave të tregut të punës. **[Dokumentit i Qartësimit fq. 7(20); Mbledhjet 5,6,8&9]** Ka marrëveshje bashkëpunimi me Institucionet e tjera të Arsimit të Lartë si në nivel kombëtar, ashtu edhe nivel ndërkombëtar dhe stafi ka mundësi të përfitojë nga kjo përmes lidhjeve të kërkimit shkencor dhe mundësive për mobilitet ndërkombëtar. Megjithatë, UPT-ja nuk mban një regjistër qendror të partneriteteve dhe lidhjeve bashkëpunuese, dhe nuk menaxhon një regjistër rrisht. **[Dokumente RVV 1.28, 1.32, 1.33, 3.42.4, 3.43, 4.16.2 & 4.16.3; Mbledhja 2] [Kapitulli III, Standardi III.4]**

1.14 NËpërmjet bashkëpunimit me institucionet shtetërore dhe private, UPT-ja ofron shërbime të ndryshme në përfitim të studentëve, duke përfshirë regjistrimin online dhe sistemin e kontrollit të notave në internet. **[RVV fq. 10; Dokumente RVV 1.8 & 4.3; Dokumenti i Qartësimit fq. 14 (6); Të dhëna shitesë 7]** Megjithatë, mundësia kryesore e lidhjeve dhe bashkëpunimit të UPT-së me organizatat e jashtme është nëpërmjet ofrimit të praktikave studimore dhe mësimore, stazhit dhe shërbimeve të sekretarisë mësimore. **[RVV fq. 10]** Nxitur nga rritja e numrit të studentëve, përpjekjet e UPT-së për të rritur numrin e kompanive publike dhe private me të cilat ka krijuar lidhje të tilla, po gjen sukses. **[Mbledhjet 2, 4-6 & 10] [Kapitulli III, Standardi III.3]**

1.15 Përgjegjësia për aktivitetet ndërkombëtare të UPT-së, duke përfshirë mobilitetin, ndahet midis departamenteve akademike dhe një njësie qendrore me përgjegjësi, që përfshijnë marrëdhëniet ndërkombëtare. **[RVV fq. 10-11; Mbledhjet 1-6 & 8-10]** Ka një numër aktivitetesh të përshtatshme, duke përfshirë marrëveshjet e mobilitetit për stafin dhe studentët, trajnimet afatshkurtra dhe konferencat, mundësitë, për të ndjekur kualifikimet e doktoratës në një universitet të huaj dhe lidhjet me projekte (shih gjithashtu pikën 3.11). **[Dokumente RVV 1.23-1.30, 2.3.1, 3.41, 4.16 & 4.17; Mbledhjet 2-4 & 8-9]** Megjithatë, UPT-ja pranon se profili i vet ndërkombëtar do të përfitonte nga forcimi institucional. **[RVV fq. 12; Mbledhjet 5, 6, 8 & 9]** Ka nivele modeste të mobilitetit hyrës dhe dalës, dhe mobiliteti i studentëve hyrës paraqet një sfidë të veçantë. **[Mbledhjet 5,6, 8 & 9]** UPT-së i mungon aftësia institucionale për të ofruar programe studimi në gjuhët ndërkombëtare, si anglishtja, dhe pranon se ofrimi i programeve të studimit në gjuhët ndërkombëtare do të ishte e dobishme, ashtu si do të ishte edhe një politikë afatgjatë e mobilitetit. **[RVV fq. 12; Dokumenti RVV 4.12; Dokumenti i Qartësimit fq. 7 (18 & 19) & fq. 13 (3); Mbledhjet 1 dhe 3]** Rekomandohet, që për të forcuar aspiratat e veta strategjike në fushën e ndërkombëtarizimit, UPT-a të zhvillojë një politikë afatgjatë për përmirësimin e numrit të studentëve dhe ekspertëve akademikë ndërkombëtarë në të gjitha departamentet dhe fakultetet. **[Kapitulli III, Standardi III.4]**

Gjetjet

Praktika e mirë

Grupi i Vlerësimit të Jashtëm nuk identifikoi asnjë karakteristikë të praktikës së mirë në këtë Fushë Vlerësimi.

Dobësi

Grupi i Vlerësimit të Jashtëm identifikoi dobësitë e mëposhtme:

- mungesa e një procesi të koordinuar për të ndërmarrë kërkime në tregun e punës dhe përdorimin e këtyre të dhënave në planifikimin e programeve (pika 1.9)
- Mungesa e gjurmimit të centralizuar dhe në mënyrë organizuar të punësimit të të diplomuarve (pika 1.10)
- Mungesa e ecurisë për krijimin e një Rrjeti Alumni, që do të vepronte si një ndërfaqe ndërmjet Universitetit dhe ish-studentëve të saj (pika 1.12).

Rekomandime

Grupi i Vlerësimit të Jashtëm dha rekomandimet e mëposhtme:

- të zhvillojë dhe të zbatojë një mekanizëm që nxit promovimin dhe zotërimin e një kulture cilësore në të gjitha njësitë dhe të gjitha nivelet dhe zhvillimin e procedurave të përshtatshme akademike të monitorimit dhe vlerësimit të cilësisë (pika 1.2)
- të ofrojë një program trajnimi për anëtarët studentë të Senatit Akademik, dhe të këshillave të fakulteteve dhe departamenteve (pikat 1.4 dhe 5.10)
- të sigurojë që Strategjia e re e Zhvillimit të identifikojë një sërë prioritetesh të Universitetit, të mbështetura nga objektivat dhe synimet e duhura që fakultetet duhet të përfshijnë në planet e tyre të fakultetit dhe të departamenteve (pika 1.6)
- të zhvillojë një studim vjetor të nevojave të tregut vendor dhe rajonal të punës dhe të përdorë rezultatet për të rishikuar dhe përmirësuar ofertën akademike (pika 1.9)
- është prezantuar një mekanizëm i organizuar në nivel qendror, për të mundësuar që punësimi i të diplomuarve dhe rezultatet të gjurmohen dhe identifikohen në mënyrë të centralizuar (pika 1.10)
- të krijojë me prioritet një Rrjet Alumni për të diplomuarit e tij (pika 1.12)
- të forcojë qasjen e vet strategjike ndaj ndërkombëtarizimit, duke zhvilluar një politikë afatgjatë për rritjen e numrit të studentëve dhe ekspertëve akademikë ndërkombëtarë në të gjitha departamentet dhe fakultetet (pika 1.15).

Pohim i veprimeve të ndërmarra

Grupi i Vlerësimit të Jashtëm pohoi ndërmarrjen e veprimeve të mëposhtme:

- veprimi për krijimin e një Zyre Karriere për Studentët dhe Këshillimi për Punësim (pika 1.11)

Gjykim

Standardet Organizimin dhe Menaxhimin e tij përmbushen kryesisht.

Fusha e Vlerësimit 2: Burimet

2.1 UPT-ja përcakton qartë të gjitha detyrat në lidhje me menaxhimin e burimeve njerëzore. Funkcionet përcaktohen në Statut, në rregulloret e fakultetit, departamentit dhe grupit të kërkimit shkencor. Universiteti zbaton një politikë rekrutimi të përshtatshme dhe të përcaktuar mirë për stafin pedagogjik, akademik dhe atij ndihmës. **[Dokumentet e Vetëvlerësimit 1.11-1.15; Të dhëna shpesh Praktika e procedurave të punësimit të stafit akademik]** Procesi i rekrutimit vihet në lëvizje nga futja e programeve të reja ose nga rritja e numrit të studentëve. **[Mbledhjet 1 & 3]** Departamenti i Burimeve Njerëzore mbikëqyr politikën e rekrutimit dhe punëson tetë persona, për të zbatuar procesin e rekrutimit në secilin fakultet dhe qendrën kërkimore. UPT-ja ka filluar ndryshimet në strukturën dhe funksionimin e vet, për të siguruar pajtueshmërinë me kërkesat e ligjit të ri dhe aktet nënligjore përkatëse, kur ato jenë të disponueshme. **[Kapitulli III, Standardi IV.1]**

2.2 UPT-ja miraton një qasje strategjike për të siguruar që i gjithë stafi të ketë burime të përshtatshme. **[Mbledhja 3]** Mbështetja financiare është në dispozicion për të mundësuar që stafi të marrë pjesë në konferenca, botime dhe aktivitete të specializuara. Janë dhënë disa shembuj se si stafi ka përfituar nga një mbështetje e tillë, duke përfshirë nismat për integrimin e stafit akademik, nëpërmjet bashkëpunimeve dhe partneriteteve me universitetet e huaja. **[Mbledhjet 8 dhe 9] [Kapitulli III, Standardi IV.2]**

2.3 I gjithë stafi përgatit një raport vjetor mbi programin e tyre të mësimdhënies dhe punën kërkimore, që vlerësohet në nivel departamenti. **[Mbledhja 8]** Performanca e punës kërkimore mbikëqyret nga këshilli i fakultetit dhe nga Qendra e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë, dhe diskutohet dhe miratohet nga Senati. **[Informacion shpesh Vlerësimi i punës kërkimore]** Për marrjen e titullit Profesor, një kandidat duhet të ketë përvojë pune ose kërkimore njëvjeçare në një universitet të njohur evropian. **[Dokumenti RVV 2.3.5; Mbledhja 9]** Këto mundësi janë vënë në dispozicion kryesisht për kandidatët e doktoraturës ose brenda kuadrit të projekteve bashkëpunuese në nivelin e fakultetit dhe janë vërejtur disa shembuj. Sidoqoftë, nuk ekziston një mekanizëm institucional për shkëmbimin e praktikës që vjen nga pjesëmarrja në aktivitete të tilla. UPT-ja zbaton një plan trajnimi të lidhur me prioritetet shkencore në nivelin e fakultetit, por kufizimet e financimit nënkuptojnë se janë të disponueshme vetëm mundësitë e trajnimit afatshkurtër për stafin akademik ose një numër i kufizuar i pjesëmarrjeve në konferencë. **[Kapitulli III, Standardi IV.3]**

2.4 UPT-ja nuk ka një politikë gjithëpërfshirëse të zhvillimit social për të gjithë studentët dhe stafin. Ndërsa Universiteti zbaton një numër të vogël të politikave të zhvillimit social, pranohet se politikat sociale duhet të pasqyrohen në strategjinë e re të zhvillimit, në mënyrë që këto politika të përfshijnë tregues të mirëpërcaktuar të ndikimit në komunitetin vendor. **[Mbledhja 10]** Për të trajtuar këtë **dobësi rekomandohet** që UPT-ja të zhvillojë dhe zbatojë një politikë gjithëpërfshirëse të zhvillimit social për studentët dhe stafin. **[Kapitulli III Standardi IV.4]**

2.5 UPT-a ka një strukturë të përshtatshme ligjore për të mbështetur procesin e hartimit të buxhetit, që përmbush kërkesat ligjore. **[Dokumenti RVV 2.5.1; Dokumenti i Vizitës, Axhenda e Bordit Administrativ fq. 2; Mbledhja 8]** Rektorati mban përgjegjësinë përfundimtare për procesin e planifikimit buxhetor, ndërsa Senati është përgjegjës për

alokimin e fondeve për departamentet. **[Mbledhja 10]** Ligji i ri cakton vetëm tre përfaqësues në Bordin Administrativ, prandaj katër fakultete nuk do të përfaqësohen në këtë organ kyç vendimmarrës. **[Kapitulli III, Standardi VI.1]**

2.6 UPT-ja siguron mjetet e nevojshme për të zbatuar politikën e vet financiare që bazohet në një kuadër ligjor transparent dhe të përshtatshëm dhe të mirëpërcaktuar. Rektorati ka krijuar tre drejtori për menaxhimin e financave institucionale pas miratimit të buxhetit institucional nga Senati dhe Këshilli Administrativ, dhe funksionet dhe përgjegjësitë e tyre përcaktohen me rregullore. **[Dokumenti i vizitës - Informacion mbi kompetencat në tre drejtori fq. 1-2] [Kapitulli III, Standardi VI.1]**

2.7 UPT-ja është subjekt i proceseve të auditimit të brendshëm, auditimit të jashtëm, Kontrollit të Lartë të Shtetit dhe Ministrisë së Arsimit dhe Sportit. Proceset e auditimit janë përcaktuar qartë në legjislacion. **[Dokumenti RVV 2.7.1] [Kapitulli III, Standardi VI.3]**

2.8 UPT-ja ka një sistem informacioni të koordinuar, dhe informacioni shpërndahet qoftë në kopje fizike ose në format elektronik. Megjithatë, përmbajtja dhe cilësia e informacionit nuk është e unifikuar në mbarë institucionin, ku disa faqe interneti të fakultetit nuk kanë informacion të rëndësishëm për studentët ose paraqesin informacion të vjetruar. Duke pranuar këtë dobësi, përfaqësuesit e UPT-së vunë në dukje se një numër i faqeve të fakultetit mbeten në ndërtim e sipër. **[Dokumenti RVV 2.7.1 fq. 16; Mbledhja 10]** **Rekomandohet** që UPT-ja të zhvillojë dhe zbatojë një proces të gjerë institucional, i cili siguron që faqet e internetit të fakultetit të ofrojnë informacion të saktë, të plotë dhe të paraqitur qartë. Janë pohuar veprimet për përfshirjen e studentëve në zhvillimin e faqeve të fakultetit, nën mbikëqyrjen e stafit akademik përkatës. **[Kapitulli III, Standardi VII.1]**

2.9 UPT-ja koordinon në mënyrë të efektshme veprimtaritë në fushën e teknologjisë. Sekretariati operon me një sistem të përshtatshëm kompjuterik online i cili u mundëson studentëve të regjistrohen në provime online. **[Dokumenti RVV 2.9.1]** Ndërsa Universitetit i janë dhuruar shumë burime për të nxënëit, UPT-ja i është përkushtuar përmirësimit të kushteve të mësimin në laboratorë, në sallat e leksioneve, sallat e seminareve dhe ambienteve të tjera. **[Udhëzime për burime]** Megjithatë, studentët raportuan në mbledhje dhe nëpërmjet anketimeve se në shumë raste pajisjet laboratorike dhe hardueri e softueri kompjuterik janë të vjetruara dhe nuk janë në gjendje të mbështesin kërkesat e modulit. **[Kapitulli III Standardi V.1]. [Anketimi i studentëve; Mbledhjet 4 & 5]** Për ta trajtuar këtë **dobësi, rekomandohet** që UPT-ja të zhvillojë dhe zbatojë një proces gjithëpërfshirës të Universitetit që siguron se kërkesat e modulit të vazhdojnë të mbështeten plotësisht nga laboratorët dhe teknologjia e përshtatshme.

2.10 UPT-ja ka dokumentacionin e kërkuar në lidhje me pronën që zotëron. Ndërsa të gjitha pasuritë e paluajtshme janë në pronësi të Shtetit, UPT-ja është përgjegjës për përdorimin dhe mirëmbajtjen e pronave. Megjithatë, shteti ka lirinë të përftojë ose të shfrytëzojë ndërtesa, për përfitim më të gjerë të shtetit, për shembull, ashtu si edhe me Fakultetin e Gjeologjisë së Minierave. **[Kapitulli III, Standardi VII.2; Kapitulli III, Standardi VII.3]**

2.11 UPT-ja siguron ruajtjen dhe mirëmbajtjen përkatëse të trashëgimisë akademike, kulturore dhe shkencore në Bibliotekën e saj Shkencore dhe Bibliotekën Kombëtare. Universiteti ndjek një politikë të mirëpërcaktuar dhe të përshtatshme, për të vlerësuar pronësinë e vet akademike dhe për të ruajtur arkivat e studimeve shkencore në Bibliotekën Shkencore dhe në nivel të departamentit dhe fakultetit. Të ardhurat sigurohen nga një shërbim fotokopje në të gjitha bibliotekat e fakultetit dhe nga shërbimet e ofruara nga Biblioteka Shkencore tek palët e treta, në këmbim të tarifave të miratuara nga Bordi Administrativ. **[Kapitulli III, Standardi VII.4]**

2.12 UPT-ja ka mekanizma të përshtatshëm për menaxhimin e aseteve të veta. Dy ndërtesa të reja kanë përmirësuar dhe rritur disponueshmërinë e të nxënësve bashkëkohor, mësimdhënies dhe lehtësirave administrative. Ndërsa ndërtesat e reja janë projektuar për të ofruar kujdes ndaj individëve me vështirësi fizike në lëvizje, ndërtesat e vjetra nuk kanë dhe u mungojnë strukturat e përshtatshme për studentët me vështirësi në lëvizje. Duke pranuar këtë dobësi, përfaqësuesit e UPT-së treguan një angazhim strategjik, për të përmirësuar strukturat në ndërtesat e vjetra për studentët me vështirësi në lëvizje. Pohohet konfirmimi i angazhimit strategjik, për të përmirësuar strukturat në ndërtesat e vjetra për studentët me vështirësi në lëvizje. **[Kapitulli III, Standardi V.1]**

2.13 UPT-ja ka një strukturë të mirëfilltë logjistike administrative e cila mundëson që të gjitha fakultetet dhe departamentet të kryejnë funksione me interes të përbashkët. Shërbimet u ofrohen palëve të treta, të cilat forcojnë lidhjet me grupet e komunitetit dhe të sektorit privat duke siguruar një burim të ardhurash. **[Dokumenti RVV 2.13.1 pfq. 10, 26, 31 & 39]**
[Kapitulli III, Standard VII.5]

2.14 UPT-ja ka një angazhim strategjik në përmirësimin e objekteve dhe infrastrukturës së saj, për zhvillimin e veprimtarive akademike dhe shkencore, në mënyrë që të sigurojë që këto të vazhdojnë të jenë të përshtatshme. **[Mbledhja 1]** Studentët u shprehën në mënyrë të pafavorshme për disponueshmërinë e lehtësive kompjuterike në mbështetje të mësimin të tyre. Përmirësimi i objekteve laboratorike, trajtimi i shqetësimeve të shëndetit dhe sigurisë dhe përmirësimi i lehtësive për studentët me vështirësi në lëvizje, janë identifikuar si fusha me përparësi për t'u zhvilluar. **[Kapitulli III, Standardi VII.6]**

2.15 UPT-ja ka krijuar dhe mirëmbajtur sistemet e duhura për të menaxhuar në mënyrë efektive kërkesat e dokumentacionit në format letre dhe elektronik. Sistemi menaxhohet dhe drejtohet nga një sekretariat qendror, me një përfaqësues në çdo fakultet. **[Kapitulli III, Standardi V.2]**

Gjetjet

Praktika e mirë

Grupi i Vlerësimit të Jashtëm nuk identifikoi karakteristika të praktikës së mirë për këtë Fushë Vlerësimi.

Dobësi

Grupi i Vlerësimit të Jashtëm identifikoi dobësitë e mëposhtme:

- mungesa e një politike gjithëpërfshirëse të zhvillimit social, për studentët dhe stafin (pika 2.4)
- përmbajtja dhe cilësia e informacionit është nuk është e njëjtë në mbarë institucionin, ku disa faqe të fakultetit nuk kanë informacion të rëndësishëm për studentët, ose paraqesin informacion të vjetër (pika 2.8)
- në disa raste, pajisjet laboratorike dhe harduerët dhe softuerët kompjuterike janë të vjetruar, duke mos qenë në gjendje për të mbështetur kërkesat e modulit (pika 2.9).

Rekomandime

Grupi i Vlerësimit të Jashtëm dha rekomandimet e mëposhtme:

- të zhvillojë dhe zbatojë një politike gjithëpërfshirëse të zhvillimit shoqëror, për studentët dhe stafin (pika 2.4)
- të zhvillojë dhe zbatojë një proces të menaxhimit të informacionit në mbarë institucionin, i cili do të bënte të mundur që faqet e internetit të fakultetit të ofrojnë informacione të sakta, të plota dhe të paraqitura qartë (pikat 2.8, 3.7 dhe 5.2)
- të zhvillojë dhe zbatojë një proces gjithëpërfshirës të Universitetit, i cili do të bënte të mundur që kërkesat e modulit të vazhdojnë të mbështeten plotësisht nga burimet e përshtatshme të të nxënit, duke përfshirë laboratorët dhe teknologjinë (pika 2.9).

Pohim i veprimeve të ndërmarra

Grupi i Vlerësimit të Jashtëm pohon ndërmarrjen e veprimeve të mëposhtme:

- Përfshirja e studentëve në zhvillimin e faqeve online të fakultetit, nën mbikëqyrjen e personelit akademik përkatës (pika 2.8)
- Angazhim strategjik për të përmirësuar strukturat në ndërtesat e vjetra, për studentët me vështirësi në lëvizje (paragrafët 2.12, 2.14 dhe 5.6).

Gjykim

Standardet për Burimet janë përmbushur kryesisht.

Fusha e Vlerësimit 3: Kurrikula

3.1 Në Deklaratën e vet të Misionit, **[Dokumenti RVV 1.3]** UPT-ja pranon pikat e forta në fushat teknike dhe inxhinierike të aplikuara. Secili prej 98 programeve të ofruara nga Universiteti, që mbulon të tre ciklet e Bolonjës, ndërtohet mbi këto pika të forta dhe përputhet me strategjinë institucionale. **[RVV fq. 21; Dokumenti RVV 3.1]** Prandaj, programet e studimit të Universitetit janë në linjë me Misionin e tij. **[Kapitulli I, Standardi I.1]**

3.2 Dokumenti Strategjik 2016-2017 **[Dokumenti RVV seksioni 4.1.1]** thekson objektivin strategjik të Universitetit, për zgjerimin e ofrimit të programeve me kohë të pjesshme dhe ato në distancë, drejt kurseve të të mësuarit dhe trajnimit të vazhdueshëm. Megjithatë, stafi i lartë drejtues pranoi **[Mbledhja 2]** se arsimi i vazhdueshëm nuk kishte qenë prioritet, pasi institucioni ishte përqendruar në tre ciklet e Bolonjës dhe jo në kurse të shkurtra. Ndërsa stafi ishte në gjendje të jepte shembuj të programeve Master, kurset e shkurtra dhe kurset e mësimit në distancë, **[Mbledhjet 8-9]** numri i kurseve, që mund të përshkruhet si arsim i vazhdueshëm, është i vogël, kryesisht Master në Transport dhe Dizajn Mode, dhe një program i të mësuarit në distancë në Inxhinieri Logjistike dhe Prodhimi. **[Kapitulli I Standardi I.2]** **[RVV fq. 24, Dokumenti RVV 3.1]** Rekomandohet që, në përputhje me Kartën e Universiteteve Evropiane për Të Mësuarit Gjatë Gjithë Jetës, Universiteti duhet t'i japë prioritet zhvillimit të programeve studimore, që janë të konceptuara për të zgjeruar pjesëmarrjen dhe për të tërhequr studentët e rritur të rikthyer.

3.3 Portofoli i programeve të ofruara nga Universiteti përputhet me sfondin dhe pikat e forta në inxhinierinë dhe teknologjinë e aplikuar. Universiteti përfshin përmirësim të mëtejshëm të ofertës së vet si një objektiv strategjik, **[Dokumenti RVV 1.3]** me qëllim që t'i orientojë studentët më afër tregut të punës. **[Kapitulli I, Standardi I.3]**

3.4 Procesi për miratimin dhe vlerësimin e programit, përshkruhet në Procedurën e Projektimit, Vlerësimit dhe Aprovimit të Programeve të Studimit. **[RVV fq. 22]** Kjo kërkon vlerësimin e përputhshmërisë së secilit program me Misionin UPT-së, me strategjinë e zhvillimit të UPT-së dhe me objektivat kombëtare dhe ndërkombëtare, përpara miratimit nga Këshilli i fakultetit përkatës. **[Dokumente RVV 1.1 & 1.7]** Drejtoria e Kurrikulës shqyrton dhe vlerëson propozimet, për të siguruar përputhjen me kërkesat kombëtare dhe ato institucionale, përpara dorëzimit në Ministri, për miratim. **[RVV fq. 23; Dokumente RVV 1.1, 1.7 & 3.15 (shqip); Mbledhja 4]** Në tërësi, këto procese bëjnë të mundur që programet e studimit të ofrohen në përputhje me strategjinë e zhvillimit të Universitetit dhe në përputhje me kërkesat vendore, kombëtare dhe ndërkombëtare. **[Kapitulli I, Standardi I.4]**

3.5 Universiteti përfiton nga një numër marrëdhëniesh të qëndrueshme, midis kompanive dhe anëtarëve të stafit individual, që mbështesin zhvillimin e programeve të veta akademike. **[Mbledhja 10]** Kualifikimet e institucionit respektohen në një nivel të lartë në tregun e punës dhe të diplomuarit e këtij institucioni konsiderohen si cilësi e lartë. **[Mbledhja 10]** **[Kapitulli I, Standardi I.12]**

3.6 Dokumenti Strategjik 2016-2017 **[1.3 Seksioni 4.1.1]** thekson ambicien e Universitetit për të rritur numrin e studentëve në tre ciklet e studimit, në përputhje me kapacitetet institucionale. Megjithatë, deri kohët e fundit, kuotat e studentëve kanë qenë nën kontrollin e drejtpërdrejtë të Këshillit të Ministrave dhe Universiteti e ka pasur të vështirë të balancojë prurjet e tij. Rritja e kohëve të fundit në numrin e studentëve që hyjnë në arsimin e lartë, së bashku me kuotat e larta të pranimeve, të përcaktuara nga Këshilli i Ministrave, kanë rezultuar në staf të pafavorshëm për studentët dhe akomodimin, në raportet e studentëve (1:39 dhe 4.03 M2: student). **[RVV fq. 22]** Studentët kanë raportuar disponueshmëri të kufizuar të burimeve fizike dhe janë shprehur se stafit të mësimdhënës i

është dashur të operojë me ato që ka pasur në dispozicion **[Anketimi i Studentëve; Mbledhjet 5-6]**, dhe stafi i lartë drejtues ka rënë dakord se kufizimet në hapësirën dhe stafin mësimdhënës janë një preokupim. **[Mbledhjet 1, 8 & 9]** Universiteti synon të adresojë këto çështje, duke përfituar nga ndryshimi në legjislacion, që i lejon universiteteve një kontroll të kuotave të studentëve të tyre, dhe përmes planeve ambicioze të ndërtimeve, që përfshijnë një ndërtim të Inxhinierisë së Ndërtimit dhe Arkitekturës. **[Dokumenti RVV 1.3; Vizita për burimet; Mbledhja 1]** Pranohet **pohimi** i veprimit për të shtuar numrin e studentëve në lidhje me kapacitetin institucional, nëpërmjet kontrollit të kuotave të studentëve dhe zhvillimit të pronave të veta. **[Kapitulli I, Standardi I.5]**

3.7 Në raportin e vetëvlerësimit, UPT pranon se nuk i ka kushtuar mjaft rëndësi informimit të studentëve rreth programeve të tyre të studimit dhe kurrikulave përbërëse dhe objektivave të mësimin. **[RVV fq. 28]** Studentëve u jepet fletëpalosje **[Dokumenti RVV 3.27]** që përmban përshkrime të gjera të temave të mbuluara dhe udhëzime studimore **[Dokumenti RVV 3.36]** që ofrojnë informacione themelore për çdo program, pa hyrë në detaje të objektivave mësimore, vlerësimeve dhe kriterëve të vlerësimit. Diskutimet me stafin dhe studentët zbuluan praktika të ndryshme në të gjitha fakultetet dhe programet, në nivelin e plotësisë së informacionit të programit, të vënë në dispozicion në faqen e internetit. **[RVV fq. 27; Mbledhjet 5, 6 & 10]** Për disa studentë, burimi kryesor i informacionit të programit ishte klasa hyrëse në fillim të çdo viti akademik. **[Mbledhjet 5, 6, 8 & 9]** **Rekomandohet** që UPT të zhvillojë dhe të zbatojë një mekanizëm, për të siguruar që të gjithë studentët të pajisen me informacione të besueshme dhe të azhurnuara të programit, duke përfshirë objektivat e mësimin dhe metodat e vlerësimit. **[Kapitulli I, Standardi I.8]**

3.8 Programet e studimeve të ciklit të parë përqendrohen për t'u dhënë studentëve njohuri të bazë dhe parimet e përgjithshme në lëndën e tyre dhe aftësinë e përgjithshme në zbatimin e këtyre parimeve. **[RVV fq. 28]** Udhëzuesit e programeve ilustrues **[Dokumenti RVV 3.36.1.1-1.6]** tregojnë lëndë hyrëse, në përgjithësi të lidhura me marrjen e teorisë bazë dhe aftësi themelore, në vitin e parë, duke vijuar në lëndë të zbatuara në vitin e tretë. **[Kapitulli I, Standardi I.8]**

3.9 Vlerësimi i udhëzuesve të programeve konfirmon pohimin e Universitetit, se programet e ciklit të parë janë ndërtuar për të zhvilluar aftësinë themelore në lëndët kryesore, duke u mbështetur në njohuri të fituara në shkollat e mesme. **[RVV fq. 29, Dokumenti RVV 3.36.1.1-1.6]** Klasa e parë, çdo vit, shërben si hyrje në studimet e vitit të ardhshëm, një praktikë që u mirëprit nga studentët. **[Mbledhjet 6, 8, & 9]** Megjithatë, Universiteti pranon se ka mungesë të strukturave institucionale, për të mbështetur aktivitetet e udhëzimit dhe orientimit të studentëve të rinj, dhe një prirje për t'u mbështetur më tepër sesa duhet në iniciativat e stafit akademik. **[RVV fq. 34]** Rekomandohet që UPT-ja të zhvillojë dhe të zbatojë një qasje më të strukturuar për udhëzimin dhe orientimin e studentëve, duke përfshirë koordinimin dhe mbështetjen e iniciativave të anëtarëve të stafit mësimdhënës. **[Kapitulli I, Standardi I.8]**

3.10 Programet e studimeve të ciklit të dytë në UPT janë të konceptuar për të siguruar një progres të natyrshëm nga cikli i parë, dhe për të marrë një nga dy strukturat alternative. Ka programe të Masterit Shkencor që zhvillojnë njohuri të avancuara në një fushë të specializuar dhe i pajisin studentët për studimet e doktoraturës, dhe programet e Masterit Profesional që synojnë të fusin aftësitë praktike inxhinierike në një fushë të veçantë të specializimit. **[RVV fq. 29; Dokumente RVV 3.1 & 3.32-3.33 (shqip)]** Programet Master përfshijnë një tezë diplome, e cila është një projekt kërkimor i pavarur dhe krijues, dhe ka për qëllim të provojë shprehitë profesionale dhe aftësinë e studentëve për të kryer studime dhe projekte në fushën përkatëse. **[Dokumente RVV 1.2 & 3.36.2.5]** **[Kapitulli I, Standardi I.9]**

3.11 Neni 4 i Statutit **[Dokumenti RVV 1.1]** thekson që oferta e arsimit të lartë të Universitetit duhet të bazohet në parimet dhe standardet e Zonës Evropiane të Arsimit të Lartë dhe të pasqyrojë parimet dhe objektivat e Procesit të Bolonjës. UPT-ja ka bërë përpjekje të konsiderueshme për të siguruar përputhjen e programeve të veta. **[Mbledhja 2]** Cikli i një programi përfshin 5-6 ECTS të studimit të gjuhës së huaj, **[RVV fq. 25; Dokumenti RVV 3.36: Informacione shtesë - Plan mësimor ilustrues]** siç kërkohet nga Senati. **[Dokumenti RVV 3.22 (Shqip)]** Qendra e gjuhëve të huaja ofron trajnime të ciklit të parë në anglisht, frëngjisht, italisht, rusisht dhe gjermanisht. **[RVV fq. 25]** UPT-ja ka një numër programesh Erasmus Mundus, Erasmus + dhe Tempus, në bashkëpunim me universitete të huaja, kryesisht në fushën e programeve të përbashkëta të doktoraturës. **[RVV fq. 25; Dokumenti RVV 3.12]** Në terësi, këto masa lehtësojnë mobilitetin e studentëve shqiptarë në Evropë dhe më gjerë. **[Kapitulli I, Standardi I.10]**

3.12 Duke pasur parasysh natyrën e zbatimit të programeve studimore të ofruara nga UPT-ja, zbatimi praktik i njohurive dhe aftësive, është një element thelbësor i ofertës akademike. Në programet e ciklit të parë, puna laboratorike, detyrat dhe projektet, plotësohen me praktikën profesionale dhe tezën e doktoraturës. **[RVV fq. 33; Informacion shtesë: Plan mësimor Ilustrues; Mbledhjet 5-6]** Programet e studimeve të ciklit të dytë kanë 30 ECTS, të ndara për praktikën profesionale dhe tezën e diplomës. **[RVV fq. 30]** Praktika profesionale mund të kryhet në kompanitë e sektorit publik ose privat. **[Dokumenti RVV 3.35 (Shqip)] [Kapitulli I, Standardi I.11]**

3.13 Disa programe studimi kanë module mbi sipërmarrjen dhe menaxhimin e biznesit. **[Dokumenti RVV 3.40 (Shqip); Mbledhjet 8-9]** Moduli i Komunikimit Inxhinierik përfshin mbulimin e përgatitjes së CV-ve në gjuhën shqipe dhe atë angleze, komunikimin verbal dhe joverbal, strategjitë e prezantimit efektiv, shkrimet e letrave të biznesit dhe aftësitë e tjera të transferueshme. **[Dokumente RVV 3.36.1.5 & 3.36.1.6]** Studentët vlerësojnë këtë modul, **[Mbledhja 6]** megjithëse tani është lëndë me zgjedhje, dhe jo pjesë e programit bazë. Stafi tregoi se këto module janë aktualisht në dispozicion në dy nga fakultetet **[Mbledhja 8]** dhe se Zyra e Karrierës ka një iniciativë për të ndërtuar mbi këto shembuj, dhe për të futur aktivitete të ngjashme në një gamë më të gjerë të lëndëve dhe fakulteteve. **[Mbledhja 10] [Kapitulli I, Standardi I.12]**

Gjetjet

Praktika e mirë

Grupi i Vlerësimit të Jashtëm nuk identifikoi asnjë karakteristikë të praktikës së mirë në këtë Fushë Vlerësimi.

Dobësi

Grupi i Vlerësimit të Jashtëm nuk identifikoi ndonjë dobësi në lidhje me këtë Fushë të Vlerësimit.

Rekomandime

Grupi i Vlerësimit të Jashtëm dha rekomandimet e mëposhtme:

- në përputhje me Kartën e Universiteteve Evropiane për të Mësuarit Gjatë Gjithë Jetës, dhënien përparësi të zhvillimit të programeve të studimit, që janë të

- konceptuara për të zgjeruar pjesëmarrjen dhe për të tërhequr studentët e rritur të rikthyer (pika 3.2)
- zhvillimi dhe zbatimi i një mekanizmi për të siguruar që të gjithë studentët të kenë informacione të besueshme dhe të azhurnuara të programit, duke përfshirë objektivat e mësimi dhe metodat e vlerësimit (pikat 3.7, 5.2 dhe 5.5)
 - zhvillimi dhe zbatimi i një qasjeje më të strukturuar për instruktimin dhe orientimin e studentëve, duke përfshirë koordinimin dhe mbështetjen e iniciativave të anëtarëve të stafit mësimdhënës (pikat 3.9, 5.2 dhe 5.5).

Pohimi i veprimeve të ndërmarra

Grupi i Vlerësimit të Jashtëm pohon ndërmarrjen e veprimeve të mëposhtme:

- përpjekjet për të shtuar numrin e studentëve, në lidhje me kapacitetin institucional, duke marrë kontrollin e kuotave të studentëve dhe duke zhvilluar pronat e veta (pika 3.6).

Gjykim

Standardet për Kurrikulën janë përmbushur plotësisht.

Fusha e vlerësimit 4: Mësimdhënia, Mësimnxënia, Vlerësimi dhe Kërkimi

4.1 UPT-ja ka mekanizma të përshtatshme për të siguruar organizimin dhe dokumentimin efikas të programeve të studimit. Janë ngritur mekanizma të përshtatshme për të miratuar programe të reja. Për nevoja të mësimdhënies dhe për të zbatuar plan-programin e planifikuar dhe programet e studimit, UPT-ja ka bashkëpunuar me një numër organizatash private dhe publike, për të punësuar specialistë të kualifikuar me kohë të pjeseshme, nga fushat përkatëse, aty ku është e përshtatshme. **[Dokumente RVV 4.2 & 4.4]** Diskutimet me stafin, studentët, alumni dhe punëdhënësit, tregojnë se zbatimi i disa marrëveshjeve të partneritetit nuk ka marrë parasysh kushtet e marrëveshjes, e cila ka ndikuar negativisht në efektivitetin e përgjithshëm të partneritetit. Shembujt përfshijnë nivelin e bashkëpunimit me organizatat partnere dhe mbështetjen që u ofrohet studentëve gjatë stazhit ose praktikave të trajnimit. **[Kapitulli I Standardi II.1] [Mbledhjet 2, 3, 5-6 & 10]** Për të adresuar këtë **dobësi, rekomandohet** që UPT-ja të zhvillojë dhe të zbatojë një mekanizëm, për të siguruar që dispozitat rregullatore të partneritetit, të zbatohen ashtu siç janë parashikuar dhe që studentët të mbështeten plotësisht gjatë stazhit ose praktikave të trajnimit. **[Kapitulli I Standardi II.1]**

4.2 UPT-ja studentët, që kanë përmbushur kërkesat e programit të tyre, i pajis me një dokument zyrtar të diplomës, që është miratuar nga Universiteti. Studentët njihen me rregulloret e vlerësimit, duke përfshirë kriteret dhe pritjet e vlerësimit dhe procedurën e shpalljes së rezultateve. Universiteti ka politika dhe mekanizma të përshtatshme dhe efektive, për të siguruar që lektorët të vlerësohen rregullisht. Studentët janë të përfshirë në procesin e vlerësimit. **[Dokumenti RVV 4.8] [Kapitulli I Standardi II.2]**

4.3 UPT-ja ka zbatuar një strukturë të përshtatshme mbështetëse, për të nxitur përmirësimin e vazhdueshëm të mësimdhënies. Megjithatë, diskutimet me stafin treguan se ofrimi i trajnimit dhe mbështetjes pedagogjike ishte më pak i zhvilluar se sa mbështetja specifike e lëndës. **[Mbledhjet 2, 3, 5-6 & 10] [Kapitulli I Standard II.3; Kapitulli I Standardi II.4]**

4.4 UPT-ja inkurajon grupet dhe projektet kërkimore, në nivel kombëtar, rajonal dhe evropian. Ndërsa Universiteti është i angazhuar në organizimin e aktiviteteve shkencore, është pranuar se nuk ka një strategji të publikuar të kërkimit institucional, për t'i dhënë prioritet aktivitetit të kërkimit. **[Mbledhjet 2, 5-6 & 10]** Çdo departament i UPT-së është organizuar në grupe lëndësh homogjene, sipas specifikës së programeve të ofruara. Derisa departamentet fokusohen kryesisht në aktivitetin e mësimdhënies, departamentet kanë lirinë që të formojnë grupe mësimore dhe kërkimore, për të përmbushur nevojat e tyre, dhe disa departamente kanë formuar grupe autonome kërkimore. Përveç kësaj, UPT-ja ka një institut kërkimi të veçantë, ku mbi 70 për qind e kohës së stafit i është dedikuar aktivitetit kërkimor shkencor. **[Mbledhjet 9 & 12]** Ndërsa Drejtoria e Kërkimeve Shkencore mbikëqyr vlerësimin e rezultateve të kërkimit shkencor, mungesa e një politike institucionale të koordinuar për t'i dhënë prioritet aktivitetit të kërkimit, nuk mbështet vlerësimin e progresit ose promovimin e rezultateve në fushat shkencore. **[Kapitulli II Standard I.4, I.6, I.7 dhe I.8]** Për të adresuar këtë **dobësi, rekomandohet** që UPT-ja të zhvillojë dhe të zbatojë një qasje strategjike për kërkimin shkencor, që identifikon prioritetet, dhe një politikë të vlerësimit dhe transferimit të rezultateve të kërkimit.

4.5 UPT-ja mbështet dhe inkurajon grupet kërkimore, aktivitetet kërkimore dhe bashkëpunimin me qendrat e tjera kërkimore dhe të projektimit. Shembujt përfshijnë pjesëmarrjen në projekte të doktoraturës dhe në veprimtaritë kërkimore të interesit kombëtar, pjesëmarrjen në projekte kërkimore evropiane dhe në projekte kërkimore dhe studime dypalëshe me universitetet e tjera perëndimore. **[Dokumenti RVV 4.13]** Raportet e

Departamentit për veprimtarinë kërkimore përfundojnë në fund të vitit kalendarik dhe përfshihen në raportin vjetor të Universitetit që i dërgohet Ministrisë. **[Kapitulli II Standardi I.2]**

4.6 Rezultatet shkencore dhe kërkimore, bëhen publike në mënyra të ndryshme, duke përfshirë prezantimet në konferenca dhe buletine kërkimore, të cilat paraqiten në nivel Universiteti ose nivel të njësisë kryesore. Disa buletine teknike shkencore botohen nga Universiteti. Për më tepër, disa rezultate të veprimtarisë kërkimore shkencore bëhen publike nëpërmjet botimit elektronik në faqen e internetit. **[Dokumenti RVV 4.18]** Megjithatë, UPT-ja ka pak marrëveshje me institucionet e tjera, të interesuara në rezultatet e kërkimeve, brenda ose jashtë vendit, dhe transferimi ose njohja e arritjeve në kërkimin shkencor është sipërfaqësore. **[Dokumenti RVV 4.20] [Kapitulli II Standard I.7]**

4.7 Vijimësia në kërkimin shkencor lehtësohet nëpërmjet përfshirjes së studentëve të doktoraturës në aktivitetet kërkimore të departamenteve. Kjo përfshin integrimin e kërkimit të punës së projektit dhe tezës, me projekte kërkimore mbi tema me interes kombëtar. Përveç kësaj, përfshirja e anëtarëve të stafit të huaj në veprimtarinë kërkimore dhe përfshirja e organizatave partnere të huaja në aktivitetet kërkimore, lehtësojnë vazhdimësinë e fushave të kërkimit shkencor. UPT-ja inkurajon fakultetet dhe departamentet, për të ftuar stafin akademik të huaj në pjesëmarrjen në aktivitete mësimore dhe kërkimore. **[Dokumenti RVV 4.12] [Kapitulli II Standardi I.6]**

Gjetjet

Praktika e mirë

Grupi i Vlerësimit të Jashtëm nuk identifikoi ndonjë karakteristikë të praktikës së mirë në këtë Fushë të Vlerësimit.

Dobësi

Grupi i Vlerësimit të Jashtëm identifikoi dobësitë e mëposhtme:

- Mungesa e menaxhimit solid të marrëveshjeve të partneritetit (pika 4.1)
- Mungesa e një politike institucionale të koordinuar për dhënie përparësi aktivitetit kërkimor dhe për të mbështetur rezultatet e vlerësimit (pika 4.4).

Rekomandime

Raporti i vlerësimit dha rekomandimet e mëposhtme:

- të zhvillojë dhe të zbatojë një politikë për të siguruar që dispozitat rregulluese të partneritetit të zbatohen ashtu siç janë parashikuar, dhe që studentët të mbështeten plotësisht gjatë praktikës mësimore ose praktikave të trajnimit (pika 4.1)
- të zhvillojë dhe të zbatojë një qasje strategjike për kërkimin shkencor që të identifikojë prioritetet dhe një politikë të vlerësimit dhe transferimit të rezultateve të kërkimit (pika 4.4).

Pohim i veprimeve të ndërmarra

Grupi i Vlerësimit të Jashtëm nuk pohoi ndonjë veprim të ndërmarrë në lidhje me këtë Fushë Vlerësimi.

Gjykim

Standardet për Mësimdhënie, Mësimnxënie, Vlerësimin dhe Kërkimin janë përmbushur kryesisht.

Fusha e Vlerësimit 5: Studentët dhe Mbështetja e tyre

5.1 UPT-ja rekruton në mënyrë aktive studentët për programet e ciklit të parë drejtpërdrejt nga shkollat e mesme shqiptare. Fakultetet organizojnë vizita të rekrutimit, ku stafi akademik dhe ai administrativ, vizitojnë shkollat dhe bëjnë prezantime të programeve të studimeve që ato ofrojnë. Ministria organizon një panair vjetor të studentëve, që zhvillohet në periferi të Tiranës. Në panair merr pjesë një delegacion me përfaqësues nga të gjitha fakultetet dhe nga Universiteti, për të ofruar informacione dhe broshura për studentët e ardhshëm. Në panairin e studentëve, Universiteti rekruton studentë, së bashku me universitete dhe kolegje të tjera nga e gjithë Shqipëria. **[RVV fq. 21; Mbledhja me Drejtorin e Burimeve Njerëzore dhe Sekretarët e Teknologjisë së Informacionit dhe Inxhinierisë; broshurë; Mbledhjet 5-6]** Programet e ciklit të dytë dhe të tretë shpallen në faqen e internetit dhe në ambientet e fakultetit. **[Kapitulli I Standardi III.1]**

5.2 Në fillim të programeve të tyre të studimit, Profesorët u japin studentëve programet lëndore, orare dhe lista literature në ditën e parë të kursit. Ndërsa ky informacion është gjithashtu në dispozicion të disa studentëve, përmes faqeve online të fakultetit, në mbledhjet me studentët dhe stafin mësimdhënës u konfirmua se kjo praktikë nuk është uniforme në të gjitha fakultetet dhe Universitetin. **[Mbledhjet 5, 6, 8 & 9]** Zbatimi i rekomandimeve të bëra në pikat 3.7 dhe 3.9, do të ndihmojë në adresimin e kësaj dobësie. **[Kapitulli I Standardi III.2]**

5.3 Raporti staf pedagogjik – studentë është 1:39. **[RVV fq. 22]** Kjo shifër është llogaritur vetëm në raport me stafin e përhershëm, ndërsa stafi me kohë të pjesshme nuk është faktor. Megjithatë studentët nuk kanë ngritur numrat e stafit si problematikë, stafi i lartë drejtues pranon se ky është një problem në të cilin po përqendrohen. **[Mbledhjet 5, 6 & 10]** Anëtarët e Senatit përshkruan dëshirën e tyre për të ulur këtë raport midis 1:25 dhe 1:17, në periudhën afatmesme, me qëllim që të reduktohet në 1:15 në pesë vjet. **[Mbledhja 10]** **[Kapitulli I Standardi III.1]**

5.4 Faqja e internetit e UPT-së ofron informacione të përgjithshme dhe secili fakultet ka faqen e vet të internetit, për t'i pajisur studentët dhe stafin me informacionet përkatëse. Përveç kësaj, stafi akademik dhe ai administrativ, komunikojnë me studentët nëpërmjet email-it. Studentët konfirmuan se janë të kënaqur në komunikimet e tyre me stafin e Universitetit. Ka variacion në lidhje me paraqitjen e informacionit dhe konsistencë në përmbajtje. Asnjë nga fakultetet dhe as Universiteti nuk ka zhvilluar ose zbatuar një mjedis virtual të të nxëniet për studentët. Universiteti ofron akses të lirë të Wi-Fi për të gjithë stafin e tij dhe studentët. **[Mbledhjet 5, 6, 8 & 9]** Stafi dhe studentët, konfirmuan që Universiteti mban një llogari personale për secilin student, që përfshin adresën e studentit dhe postën elektronike të tij. **[Mbledhja me Drejtorin e Burimeve Njerëzore dhe Sekretarët e Inxhinierisë së Teknologjisë së Informacionit]** **[Kapitulli I Standardi III.3; Kapitulli I Standardi III.5]**

5.5 Në ditën e tyre të parë në Universitet, Rektori jep një prezantim hyrës për të gjithë studentët e rinj. Dekanët dhe drejtorit u japin një fjalim mirëseardhje studentëve të rinj të Universitetit ose fakulteteve të tyre përkatëse. Studentët, më pas, marrin një informim nga kreu i departamenteve të tyre përkatëse. Studentët konfirmuan se informacioni që ata marrin është i mjaftueshëm për nevojat e tyre. **[Mbledhjet 5, 6 & 10; Mbledhja me Drejtorin e Burimeve Njerëzore dhe Shefat e Sekretarisë së Inxhinierisë së Teknologjisë së Informacionit]** Lidhur me ofrimin e kujdestarëve individualë për studentët e ciklit të dytë dhe të tretë, çdo grup kërkimor në një departament emëron një student kujdestar. Diskutimet me stafin dhe studentët konfirmuan natyrën e kënaqshme të këtyre rregullimeve. **[Mbledhjet 5-6]** **[Kapitulli I Standardi III.3; Kapitulli I Standardi III.5]**

5.6 UPT-ja mbështet studentët me aftësi të kufizuara, studentët me prindër me aftësi të kufizuara, studentët që janë jetimë, studentët që kanë vështirësi financiare, studentët që janë fëmijë të oficerëve të policisë të rënë në krye të detyrës, si dhe studentët romë dhe ballkanas-egjiptianë, duke ofruar bursa në shumën e plotë, ose të pjesëshme, të tarifave të tyre të shkollimit. **[Dokumente RVV 5.20-5.22; Mbledhjet 4-6]** Përtej kësaj ndihme financiare, nuk ofrohet mbështetje shtesë për studentët në kategori të veçanta, përveç ofrimit të rampës për lehtësi lëvizje të personave në karrige me rrota, në disa zona. Anketimet me stafin dhe studentët, treguan se kjo dispozitë është e pjesëshme dhe është një fushë preokupimi. Kjo u konfirmua në mbledhjet me studentët dhe stafin e lartë. Ndërsa ndërtesa e re ka i ka tualetet e pajisura për personat me aftësi të kufizuara, u konfirmua nga stafi dhe studentët se kjo nuk ndodh në të gjitha ndërtesat e Universitetit. Stafi i lartë drejtues konfirmoi se kjo është një fushë me përparësi për zhvillimin e infrastrukturës. Ky vëzhgim i pranuar në pikën 5.12 do të ndihmojë në adresimin e kësaj dobësie. **[Anketimi i stafit; Anketimi i Studentëve; Mbledhjet 4-6] [Kapitulli I Standardi III.4]**

5.7 Studimet me kohë të pjesëshme janë ofruar nga Universiteti në të kaluarën, por, për momentin, politika aktuale e qeverisë nënkupton që kjo dispozitë do të hiqet. **[Mbledhja 2]**

5.8 Përgjegjësi i Bibliotekës Shkencore, biblioteka kryesore e Universitetit, është ngarkuar për ofrimin e shërbimeve bibliotekare. Raporti i vetëvlerësimit thotë se “jo të gjitha tekstet janë të një cilësie të mirë dhe në sasi të mjaftueshme”. Diskutimet me stafin dhe studentët, konfirmuan mungesën e teksteve të përditësuara në të gjitha bibliotekat dhe mungesën e librave ose revistave elektronike. **[Vizita për Burimet; Mbledhjet 4-6 & 8-9]** Kjo mungesë, aktualisht, është përmirësuar nga sigurimi i materialeve të fotokopjuara. Mbledhjet me stafin e lartë drejtues dhe mësimdhënës, konfirmuan se kjo është një fushë me përparësi për t’u përmirësuar dhe se ka filluar një projekt për ta trajtuar këtë dobësi. **[Kapitulli 1 Standardi III.5] [Mbledhjet 4 & 8-9]** Është i pranuar pohimi i këtij veprimi për të adresuar cilësinë dhe sasinë e teksteve shkollore. Sidoqoftë, rekomandohet që UPT-ja të miratojë masa për të përmirësuar stokun e librave dhe t’i japë përparësi projektit, që tashmë është duke u zhvilluar, për të rritur aksesin në librat dhe revista elektronike.

5.9 Studentëve të ciklit të parë u jepet, nga pedagogët e tyre, informacion kontakti për personin kujdestar (apo përgjegjës) të tyre dhe studentët konfirmojnë se i gjejnë këto rregullime si të kënaqshme. Secilit grup mësuesor i është caktuar një kujdestar, dhe Fakulteti i Teknologjisë së Informacionit ka si politikë që një pedagog të shërbejë si kujdestar në një ose dy klasa. Megjithatë, për studentët e ciklit të parë nuk ekziston një sistem formal për caktimin e kujdestarëve individualë në të gjithë Universitetin. **[Mbledhjet 5-6 & 8-9; Mbledhja me Drejtorin e Burimeve Njerëzore dhe Sekretaret e Inxhinierisë së Teknologjisë së Informacionit] [Kapitulli I Standardi III.6]**

5.10 Studentët kanë një Këshill të Studentëve ku mund të debatojnë çështje dhe të ngrenë problemet që ata dëshirojnë, që përfaqësuesit e studentëve t’i përcjellin në Këshillat e Fakultetit dhe në Senatin Akademik, për zgjidhjen e tyre. Ndërsa diskutimet me studentët konfirmuan pjesëmarrjen e përfaqësuesve të studentëve në këto mbledhje, asnjë përfaqësues i studentëve nuk ishte i pranishëm, për të ofruar një pikëpamje mbi shkallën e angazhimit të studentëve në jetën institucionale të Universitetit. Raporti i vetëvlerësimit tregon se nuk ka një nivel të lartë të angazhimit të studentëve me proceset institucionale të diskutimit dhe vendimmarrjes. Diskutimet me stafin e lartë drejtues konfirmuan se kjo është diçka që Universiteti dëshiron ta përmirësojë. Sidoqoftë, është vërejtur se Këshilli i Studentëve nuk ka ndonjë hapësirë të dedikuar për zyrë ose sigurim financiar nga buxheti. Përveç përfaqësimit formal në mbledhjet e komisioneve, stafi dhe studentët treguan se ka edhe komunikim të drejtpërdrejtë nga sallat e leksioneve, nëpërmjet komunikimit online në faqen e internetit të Universitetit dhe në disa raste përmes faqeve të mediave sociale. **[Mbledhjet 2, 3 & 5-6] [Kapitulli I Standardi III.7]**

5.11 Raporti i vetëvlerësimit thekson se, ndërsa Universiteti mbështet jetën kulturore të studentëve, aktivitetet e mbështetura financiarisht janë të rralla, dhe diskutimet me studentët e konfirmojnë këtë. Studentët deklaruan se do ta vlerësonin zhvillimin e më shumë aktiviteteve shoqërore. Stafi i lartë tregoi se një sasi e caktuar nga buxheti është parashikuar në mbështetje të aktiviteteve të studentëve dhe se studentët janë të pranishëm në Senatin Akademik për miratimin e buxhetit. **[Mbledhjet 3 & 5-6] [Kapitulli I Standardi III.8]**

5.12 Është një kërkesë ligjore që studentët e ciklit të parë të kenë një periudhë stazhi gjatë vitit të tretë të programit të tyre. Mbledhjet me stafin mësimdhënës dhe studentët, konfirmuan se UPT-ja e përmbush këtë detyrim. Studentët raportuan se nganjëherë këto praktika çojnë në punësim, por kjo nuk ndodh gjithmonë. Ndihma që studentët marrin nga stafi akademik në gjetjen e punësimit pas diplomimit është e ndryshueshme dhe, normalisht, bazohet në forcën e kontakteve personale. **[Mbledhjet 5-6 & 8-9] [Kapitulli I Standardi III.9]**

5.13 UPT-ja, dikur, kishte një zyrë karriere, por kur fondet për të mbaruan, zyra u mbyll. Universiteti tani ka në plan të hapë një zyrë tjetër karriere, më vonë, gjatë këtij viti akademik. Pohimi i këtij veprimi vërehet në pikën 4.14. **[Dokument i RVV 5.10; Dokumenti i Qartësisimit fq. 16] [Kapitulli I Standardi III.9]**

5.14 Gjatë një mbledhje me përfaqësues të përzgjedhur të partnerëve të jashtëm, që ishin kryesisht alumni, u vunë re se pjesëmarrësit ishin unanimit në shprehjen e kënaqësisë për marrëdhënien që ata kanë me Universitetin. Është vërejtur se disa kompani të përfaqësuara kanë ofruar praktika për studentët, por këto ishin të natyrës ad hoc dhe konfirmuan se nuk ekziston një sistem formal. **[Mbledhja 12]** Krijimi i një Rrjeti Alumni do të ishte një hap pozitiv për Universitetin në formalizimin e lidhjeve të tij me biznesin dhe industrinë, me qëllim të përmirësimit të punësueshmërisë së studentëve dhe krijimit të mundësive për përafrimin e kurrikulave me kërkesat e tregut. **[Kapitulli I Standardi III.9]**

Gjetjet

Praktikë e mirë

Grupi i Vlerësimit të Jashtëm nuk identifikoi karakteristika të praktikës së mirë në këtë Fushë të Vlerësimit.

Dobësi

Grupi i Vlerësimit të Jashtëm identifikoi dobësinë e mëposhtme:

- sigurimi i papërshtatshëm i teksteve akademike, si për sa i përket cilësisë, ashtu edhe sasisë (pika 5.8).

Rekomandime

Grupi i Vlerësimit të Jashtëm identifikoi rekomandimin e mëposhtëm:

- Të miratojë masa për të përmirësuar stokun e librave dhe të përcaktojë prioritetet e projektit, që tashmë ka filluar të zbatohet, për të rritur aksesin në librat dhe revistat elektronike (pika 5.8).

Pohim i veprimeve të ndërmarra

Grupi i Vlerësimit të Jashtëm pohon ndërmarrjen e veprimeve të mëposhtme:

- Projekti për të trajtuar cilësinë dhe sasinë e teksteve akademike (pika 5.8).

Gjykim

Standardet për Studentët dhe Mbështetjen e tyre janë përmbushur kryesisht.